

NJOFTIM PËR APLIKIM

Përzgjedhjen e Gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës voton brenda muajit prill 2017, kandidaturën për gjyqtarin e ri të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Këshilli i Evropës fton qeverinë shqiptare të paraqet së brenda datës 20 mars 2017, listën me propozime për tre kandidaturat më të përshtatshme për këtë pozicion.

Ky njoftim për aplikim bazohet në Udhërrëfyesin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM (2012) 40-add, datë 29.03.2012. Mandati i gjyqtarit është për një afat prej 9 (nëntë) vjetësh dhe mbaron pas përfundimit të këtij afati ose kur ai/ajo arrin moshën 70vjeç. Kandidatët nëse zgjidhen, duhet të jenë në gjendje të mbajnë këtë detyrë për të paktën sa gjysmën e mandatit 9 –vjeçar, para se të arrijnë moshën 70 vjeç.

Aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë arsim të lartë juridik;
- Të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lector i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në Administratën Publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës, kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e drejtësisë;
- Të mos ketë mbajtur funksione politike në Administratën Publike, ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- Të ketë karakter të lartë moral në përputhje me pikën 1 të nenit 21 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Të zotërojë një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht), si dhe së paku të ketë njohuri bazë të gjuhës tjetër. Do të konsiderohet përparësi zotërimi i të dyjave gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës

Dokumentet që duhet të dorëzohen janë këto:

- Kërkesë për aplikim;
- Kopje e kartës së identitetit;
- CV-në në gjuhën shqipe dhe CV të formatizuar sipas modelit në linkun e mëposhtëm, në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht).
- <http://assembly.coe.int/CommitteeDocs/2009/ModelCVEN.doc>
- Dokumente të diplomimit dhe kualifikimeve shkencore;
- Dokumente që provojnë vjetërsinë në profesion;
- Dokumente që provojnë njohjen dhe zotërimin e gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës apo gjuhëve të tjera të huaja.
- Vetëdeklarim që është person i pa dënuar /dënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar përkryerjen e krimeve, nëpërputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 138/2015 “Për garantimin e interesit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar;
- Vetëdeklarim se interesat private nuk përmbajnë burime të paligjshme financiare, fshehje të pasurive, deklaram të rreme apo konflikt interesi, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin e kontrollit të pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- (Deklarimi i rremë përveç përgjegjësisë penale sipas ligjit, sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme).
- Dokumente të tjera në funksion të përmbushjes së kriterëve të tjera plotësuese.

Pas vlerësimit të dosjeve të aplikimit, kandidatët mund t’i nënshtrohen intervistimit, ku një pjesë e pyetjeve do të jenë në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës.

Afati I dorëzimit të aplikimit: 30 nëntor 2016

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.1 Tiranë

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

tel: 04 22 77 401

<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/njoftim-per-aplikim1478005375&page=1>